Aksioni 2: Rinia, arsimi, qytetaria lokale dhe evropiane
(«Pjesëmarrja e rinisë në jetën lokale»)

BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

- Partnerë
- Hyrje
- Aksioni 3.1 : «Afrim i informatave lokale më afër qytetarëve»
- Aksioni 3.2 : «Zhvillimi i një poli të resurseve normand-maqedonas»
- Ndikimi i pritur në fund të projektit

Partnerë

Koordinim:

Normandia e Posthme:

- Shtëpia e Evropës i Caen-it Normandia e Poshtme (Maison de l'Europe de Caen Basse-Normandie / MECBN)

Maqedonia:

- Agjencia e Demokracisë Lokale (ADL) i Kosovës/Kumanovës
- SEGA-Koalicioni i organizimit rinor

Partnerët e paraparë (listë jo e plotë dhe në zhvillim gjatë projektit):

Normandia e Posthme dhe Franca:

- Shërbimi rajonal i angazhuar për rininë dhe sportin
- Shërbimi rajonal i angazhuar për punësim, trajnim profesional dhe mësim
- Shërbimi rajonal i angazhuar për edukimin dhe arsimin sipëror
- Drejtoria rajonale për rininë dhe sportin (DRDJS)
- Institucion publik i shkallës së dytë
- Delegacioni akademik i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i bashkëpunimit (DARIC)
- Universiteti dhe Rektorati i Caen-it

Maqedonia:

- Ministria i Rinisë dhe Sportit
- Shoqata YMCA Maqedoni
- Gjimnazi me klasa frankofone
- Qendra SALTO Youth

Hyrje

Sa i përket rinisë, politikat lokale kanë tre tendenca: t i injorojnë, t i shohin si një kërcenim ose të shihen si një burim.

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

Nga ana maqedonase, rinia është e injoruar nga politikat lokale në një pikë të tillë që nuk ekzistojnë në komunat për shërbim ose si përgjegjës për rininë.
Kurse në Francë, rinia është shumë e më shumë e dukshme si një kërcënim, një perceptim i tillë i rinisë i cili shprehet aq në media që në fjalimet politike. Nuk është e rrallë që politikat lokale rinore përzihen me politikat paragjykuese i delinkuencës. Një konstatim i tillë kombëtar është gjithashtu i vlefshëm, duke mos gjeneralizuar, në Normandinë e poshtme. Nëse vështirësitë në përkufizim dhe në vënien në veprim të politikave lokale rinore janë të ndryshme në të dy territoret partner, kjo shpreh se të dy dëshirojnë te shohin te të rinjtë një burim dhe jo të injorohen apo të shihen si një kërcënim.

Të shihen të rinjtë si një resurse apo burim, është ti shohim si aktor të jetës lokale e cila duhet të implikohen në punimet dhe në vënien në veprim të politikave publike. Në fakt, që resurset potenciale i të rinjve mund të shprehen, është e nevojshme që ato të integrohen në jetën lokale dhe në marrjen e vendimeve përkatëse, Aq nga ana maqedonase (në kuadrin e Strategjisë kombëtare Rinore) që në Normandinë e poshtme (në kuadrin e Shemës rajonale për rregullim të territorit/SRADT), pjesëmarrja e të rinjve paraqitet si një prioritet politik afatgjatë. Ky vullnet për pjesëmarrjen e të rinjve nuk është vetëm një realitet në këto dy territore, është gjithashtu rasti në tërë Evropën, aq sa në planin D (Demokraci, Dialog dhe Debat) nga Komisioni evropian që në Kartën mbi pjesëmarrjen e të rinjve të Këshillit Evropian.

Prioritetet politike në fushën e pjesëmarrjes e të rinjve nuk mjafton, ato duhet të jenë të shoqëruara me akte konkrete në nivelin lokal. Akti 2 Pjesëmarrja i të rinjve në jetën lokale i prezent projektit do të propozoj pra të bëj një pjesëmarrje e të rinjve në jetën lokale dhe në marrjen e vendimeve përkatëse në këndin e intervenimit më të madh i cili do të prapësoj aq sa në nivelin i autoriteteve lokale, institucionet shkollore që në shoqatat. Për të bërë , metodologjinë e punës së propozuar parashihet një kohë për konsultimin e të rinjve nga territoret e ndryshëm përkatës, sepse është për dhe me ato që ky program bashkëpunimi duhet të vendoset në vend.

Për të qenë rrjedhja i këtij akti i qëndrueshëm, principet e Kartës për bashkëpunim të decentralizuar për zhvillim të qëndrueshëm do të krijojnë një udhërrëfyes për realizimin e aktiviteteve. Kështu, jo vetëm të rinjtë do të jenë të kyçur në aktivitetet e aktit, por bashkësia e aktorëve përkatës dhe së pari autoritetet lokale. Këto të fundit do të jenë një nga shënjestrat kryesore të projektit, do të thotë jo vetëm për t ju ndihmuar të vënin në veprim orientimet politike aq sa lokale që në ato evropiane të cekura më lartë.

Aksioni 2.1: «Të ndihmohen autoritetet lokale në përkufizimin dhe në vënien në veprim të politikave rinore të qëndrueshme dhe pjesëmarrëse»

Objektivet specifike:

Organizimi i takimeve, trajnimet, atelietë në të dy krahinat mbi:

- Njoftimet, të rinjtë dhe autoritetet lokale
- Format e ndryshme të pjesëmarrjes i të rinjve në nivelin lokal, veçanërisht format institucionale
- Marrëdhëniet në mes medieve, të rinjtë dhe autoritetet lokale
- Këmbime mbi aktivitetet nëpërmjet internetit
- Publikimi i një udhërrëfyes pedagogjik mbi përkufizimin dhe vënies në veprim të politikave lokale të qëndrueshme rinore duke i shoqëruar ato
- Takime rinore në mes dy territoret, të hapur me Evropën, për vënien e përbashkët aktivitetet e mëparshëm

Përshkrimi/Zhvillimi:

Aksioni 2: Rinia, arsimi, qytetaria lokale dhe evropiane
(«Pjesëmarrja e rinisë në jetën lokale»)

Aktiviteti 1 :

Të gjitha politikat lokale rinore që synojnë pjesëmarrjen e tyre mund të realizohet vetëm me një transmetim efektiv të njoftimit. Një punë refleksioni dhe formimi imponohet pra mbi njoftimin i të rinjve në nivelin lokal në të dy territoret, duke ruajtur në mendje që kjo ndodh në hapësirën evropiane.

Aktiviteti i parë i aksionit 2.1 do të përbëj pra në mbajtjen e takimeve/ trajnimeve në territoret përkatës me temat që vijojnë:

- Vendi i njoftimit i të rinjve në zhvillimin e politikave publike për edukim dhe rini
- Analiza i metodologjive të njohurive dhe eksperienca i pjesëmarrësve.
- Refleksioni mbi sfidat e ndarjes së pushtetit, lidhur me zhvillimin e qasjes së njoftimit i të rinjve në nivel lokal
- Politikat komunale për informim i të rinjve në mjediset rurale dhe urbane.
- Të zgjedhurit lokal dhe shoqërues dhe raporti i tyre në transmetimin e informatës
- Të rinjtë dhe raporti i tyre në qasjen dhe në hulumtimin e informatave
- Pjesëmarrja i të rinjve në përkufizimin e nevojave të veta në informacione (punë mbi bazat e Kartës evropiane i Informacionit Rinor) Metodat pedagogjike që vijojnë do të përdoren: këmbim eksperiencash, paraqitja e veglave, ekspoze/dëshmi, vënia në praktik.

Në këto takime/trajnime, theksi do të vendoset mbi informacionin që u përket institucioneve publike lokale (autoritetet lokale, shoqatat etj.), mekanizmat e tyre për marrjen e vendimeve dhe funksionimi i instancave reprezentative në të dy territoret. Këto takime do të zhvillohen në të dy anët dhe do të shërbejnë për përgatitjen e takimeve të përbashkëta.

Në nivelin e këtij aktiviteti, një lidhje do të vendoset me aksionin 1.2 «Qasje lokale të qytetareve me internetin dhe me faqen e hapur (open source), një përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm të territoreve në rrugë dezertimi», pikërisht mbi pjesën përkatëse të përdorimit të teknologjive të reja të informimit dhe të komunikimit (TRIK) për t u informuar mbi aktualitetin lokal. Konkretisht, kjo do të thotë që pjesëmarrësit dhe ndërhyrësit do të jenë të përbashkët në aktivitetet i të dy aksioneve.

Aktiviteti 2:

Pjesëmarrja e të rinjve në marrjen e vendimeve dhe ne jetën lokale përmban forma të ndryshme: shoqata, manifestime, peticione, këshilla për të rinjtë, forume për të rinjtë, etj.

Aktiviteti i dytë do të ketë për qëllim të këmbejnë mbi eksperiencat e lidhura me pjesëmarrjen e të rinjve. Theksi do të vendoste mbi pjesëmarrjen institucionale në veçanti në nivelin të autoriteteve lokale, objektivi duke qenë që ky aktivitet kontribuon në përmirësimin e kualitetin e pjesëmarrjes ti të rinjve në punimet dhe në vënien në veprim të politikave lokale për të rinjtë.

Objektivat do të jenë siç vijojnë:

- Gjendja në vende tjera/format e participimit i të rinjve në të dy territoret dhe në Evropë
- Të rinjtë si burim të jetës lokale
- Principet dhe sfidat e pjesëmarrjes i të rinjve
- Të dallohen më mire dhe të kuptohen më mirë format e ndryshme të pjesëmarrjes të së rinjve
- Formalizmi i pjesëmarrjes i të rinjve në instancat drejtuese të shoqatave
- Formalizmi i pjesëmarrjes i të rinjve në autoritetet lokale

Me qëllim që të regjistrohet ky aktivitet në një logjik të zhvillimit të qëndrueshëm, theksi do të vendoset mbi pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal. Për këtë, ndërveprimet në mes të rinjve dhe ambienti të tyre do te jenë veçanërisht studiuar dhe valorizuar (familja, shkollat, shoqatat, ndërmarrjet, institucionet, etj.)

Në nivelin e këtij aktiviteti, një lidhje do të vendoset me aksionin e parë 1.1« Qytetarët aktiv- partner në zhvillimin e

qëndrueshëm», pikërisht në pjesën përkatëse të përdorimit të Teknologjive të Reja për informim dhe komunikim brenda mekanizmat për konsultim të qytetarëve.

Aktiviteti 3:

Informimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në nivelin lokal janë të lidhura ngushtë me qasjen dhe prezencën e tyre në media lokale. Kjo mund të krijoj një ndër burimet e parë të informimit rinor mbi institucionet dhe sfidat lokale ashtu si edhe mund të formojnë një ndër burimet e parë influence e të rinjve. Por për këtë, duhet gjithashtu që të rinjtë të kenë qasje me media kualitative dhe kjo të merret në konsideratë për pikëpamja e tyre. Për të punuar mbi këtë tematik, atelie do të organizohen në të dy territoret mbi temat që vijojnë:

- Të parashikohen strategjitë pluri-mediatike dhe përdorimi i mediave nga të rinjtë
- Përdorimi i mediave lokale nga autoritetet lokale për të përmirësuar komunikimin me të rinjtë
- Përdorimi i internetit nga të rinjtë
- Marrëdhëniet e mirëmbajtura nga mediat apo korrespondentët lokal me autoritetet dhe shoqatat lokale në fushën e informimit që kanë të bëjnë më rininë.

Në nivelin e këtij aktiviteti, një lidhje do të vendoset me disa aktivitete nga aksioni 3 «Shoqata e informimit dhe mediat », pikërisht me pjesën që kanë të bëjnë me trajtimin e aktualitetit lokal nga mediat.

Këto tre aktivitete për trajnim, për takimet dhe atelietë do të zhvillohen të shpërndare në të dy territoret me pjesëmarrjen e të rinjve, përgjegjës komunal dhe shoqërues. Një vënie e përbashkët të punimeve do të realizohet nëpërmjet hapësirës « Rini, edukim dhe qytetërim nga portali i bashkëpunimit norman-maqedonas i cili do të realizoj Courrier i Ballkanit. Këto aktivitete do të jenë të ndara nga një ekip i përzier ndërhyrës nga Normandia e poshtme dhe maqedonase. Së bashku, do ti drejtojnë aktivitetet në mënyrë që bashkësia e dokumenteve të prodhuar jep në realizimin i një dokumenti pedagogjik i cili përmban mbi përkufizimin dhe vënien në veprim të politikave lokale të qëndrueshme rinore duke i shoqëruar ato.

Aktiviteti 4: (kërkesë financimi të bëhet nga programi evropian «Rinia në aksion»)

Gjatë vitit të dytë të projektit, një takim do të organizohet në mes të rinjve norman dhe maqedonas të cilët kanë marr pjesë në aktivitetet e aksionit 2. Ky takim do të jetë i rrethuar nga një ekip i përzier norman-maqedonas. Ky aktivitet do të jetë i hapur për pjesëmarrje e të rinjve nga Evropa dhe do të flitet për një kërkesë financimi në programin evropian Rinia në Aksion. Gjatë këtij takimi, të rinjtë e implikuar do të punojnë në elaborimin e një plani të përbashkët punues i cili do e definon vazhdimin e aksioneve në funksion të pritjeve të të rinjve dhe obligimeve të lidhura me resurset disponuese ose që mund të mblidhen.
Për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve nga pjesa tjetër e Evropës, është e rëndësishme të precizohet se prioritet do t ju jepet të rinjve të cilët vijnë nga kolektivitetet lokale dhe shoqatat të cilat tanimë janë të angazhuara në një bashkëpunim me njërin apo kolektivitetin tjetër. Takimi mund të mbledh nga 20 deri në 60 të rinj varësisht nga financat që mund të mblidhen. (sidomos nga programi Rinia në aksion).

Aktiviteti 5:

Duke u nisur nga punët e aktiviteteve 1 deri 4 si dhe nga përvojat e aksionit 1 për sa i përket politikës rinore, realizim dhe publikim i një doracaku pedagogjik mbi definimin dhe vënien në praktikë të politikave rinore të qëndrueshme lokale, duke i kyçur aty të rinjtë.

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

Aksioni 2.2: «Aktorët e rinj dhe rruga e tyre jetësore:të orientohesh në formimin dhe profesionin tënd, të jesh mobil në Evropë»

Qëllimet specifike:

Orientimi i të rinjve është një pyetje qendrore e politikave rinore dhe edukative si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë lokal, porse edhe në atë evropian. Kësaj duhet shtuar edhe çështjen e mobilitetit. Vetëm orientimi i mirë dhe mobiliteti i të rinjve mund të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm të territoreve: orientimi duhet të mban llogari për resurset e të rinjve, për pritjet e territorit, etj.
Për sa iI përket orientimit dhe mobilitetit, konstatimet poshtë -normane dhe maqedonase janë identike (gjithmonë në proporcione të ndryshme): të rinjtë e këtyre dy territoreve ballafaqohen me vështirësi për të shfrytëzuar sa më mirë ofertën edukative dhe të formimit të hapësirës së tyre jetësore, janë pak mobil porse e lëshojnë rajonin për të mos u kthyer më sepse aty nuk i gjejnë formimet të cilat i kërkojnë. Këto preokupime të përbashkëta, si dhe sfida të cilën e paraqesin ato, përbëjnë objekt të një aktiviteti specifik.

Të rinjtë e organizuar në shoqata ose në këshille gjimnaziste/ studentore mund të luajnë një rol qenësor në përmirësimin e politikave lokale dhe institucionale në kuptimin e orientimit dhe mobilitetit. Për këtë arsye aksioni 2.2 do të organizohet rreth mbajtjes së një takimi të përbashkët të të rinjve poshtë-normane dhe maqedonas me këto tema.

Përshkrimi/ Rrjedhja:

Dy aktivitete do të mbahen në këtë aksion 2.2:

1. Organizimi i një takimi normane- maqedonas me përfaqësues të shkollave të mesme mbi temën e orientimit dhe mobilitetit të të rinjve.
2. Realizimi i një doracaku me praktika të mira mbi orientimin dhe mobilitetin e të rinjve.

Ky takim do të përfshin qëllimet e mëposhtme:

- Të identifikon sfidat e orientimit të të rinjve në të dy territoret (shkollim, formim, profesion, mobilitet)
- Të identifikon praktikat të cilat kanë për qëllim të shoqërojnë orientimin e të rinjve
- Orientimin e të rinjve si sfidë e zhvillimit të qëndrueshëm, nga niveli lokal në atë evropian
- Roli i koordinatorit mund të merret nga ana e autoriteteve lokale për sa i përket orientimit të të rinjve
- Profesionet specifike të orientimit të të rinjve
- Informim dhe orientim
- Të rinjtë dhe raporti i tyre me informimin për orientimin e tyre.

Pjesëmarrësit e këtij takimi do ta përgatisin atë vazhdimisht duke mbledhur të dhëna të cilat kanë të bëjnë me territorin e tyre. Pas takimit, do të organizohet një aksion nga ana e të rinjve në vet territorin e tyre të origjinës për të dëshmuar rreth asaj që kanë këmbyer me kolegët e tyre nga rajoni tjetër. Të shoqëruar nga profesionistë të orientimit, pjesëmarrësit e takimit do të përpilojnë një doracak të përbashkët analizash krahasuese për sa i përket sfidave lokale dhe evropiane për territorin e tyre e që ka të bën me orientimin dhe mobilitetin. Ky doracak iI cili ka qëllim të tij organizatat rinore (gjimnaziste, studentore, qytetare) do të përmban poashtu edhe një pjesë praktike të përbërë nga skeda dhe shembuj të aktiviteteve konkrete të cilat do të mundësojnë përmirësimin e orientimit dhe mobilitetit të të rinjve. Për arsye financiare dhe mbrojtje të ambientit jetësor, ky doracak do të publikohet vetëm se në versionin elektronik. Doracaku ju destinohet udhëheqësve të shoqatave gjimnaziste dhe studentore si dhe drejtuesve të institucioneve lokale dhe është shumë e mundshme që ky publik të jetë i kapshëm me një shpërndarje informatike të doracakut.

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

Me qëllim që të takojmë aktorët të cilët kanë të bëjnë me orientimin, takimi nuk do të përfshijë vetëm të rinjtë, porse edhe përgjegjës të institucioneve edukative dhe të formimit, të përzgjedhur lokal, etj.

Çështja e përdorimit të TRIK (Teknologjive të Reja të Informimit dhe Komunikimit) në shërbim të orientimit dhe mobilitetit të të rinjve, do të jetë në thelb të këtij aktiviteti. Mund të realizohet bile edhe një lidhje me aksionin 1.2 për sa i përket qasjes së të rinjve drejt informatave nëpërmes internetit dhe mundësisht edhe formimit në distancë.

Aksioni 2.3: «Frankofonia, mbajtëse e vlerave të përgjithshme humanitare qytetare»

Qëllimet specifike:

Të rinjtë poshtë-normand dhe maqedonas kanë të përbashkët atë që janë rini evropiane, por nuk duhet harruar se të gjithë ata janë rini e frankofonisë. Gjuha frënge, përkrah maqedonishtes, ngelet një gjuhë e huaj e mësuar veçanërisht nga liderët e rinj, po ata liderë të cilët i gjejmë shpesh nëpër shoqata, administratë, etj. Nëse gjuhët janë një vegël komunikimi, aq më pak duhet harruar se ato në vete përmbajnë tradita dhe një mënyrë të të menduarit. Gjuha frënge pa dyshim se qarkullon përgjatë Evropës dhe botës një traditë të mendimit të lirë dhe të humanizmit. Që nga Revolucioni francez e deri te «French doctors», Franca dhe francezët janë mbajtës të një koncepti të caktuar të angazhimit: mbrojtja e së drejtës, vullnetarizmi, humanizmi, etj. Në kontekstin e ndërtimit evropian dhe të mondializimit, këto vlera të cilat i qarkullon frankofonia duhet të afirmohen në mënyrë që frankofonët dhe në veçanti të rinjtë të ndjehen edhe ata mbajtës të këtyre vlerave. Për të kontribuar në vlerësimin e këtyre vlerave të frankofonisë, aksioni 2.3 propozon të përcaktojë një seri të aktiviteteve të këmbimit të të rinjve vullnetarë në të mirë të frankofonisë dhe vlerave të saj:

- Këmbime të të rinjve vullnetarë frankofonë (Shërbimi vullnetar europian/ SVE, AFVP, Shërbimi për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ SBZ, Guilda Europiane e Raid, etj,)
- Mbështetje në mësimdhënien e frëngjishtes
- Kontakte dhe këmbime ndër-institucionale
- Mobilitet të të rinjve
- Dhurim veprash dhe materiali pedagogjik dhe audiovizual.

Përshkrimi/ Rrjedhja:

Aktiviteti 1:

Komiteti i pilotimit te aksionit «Shoqëria e informimit dhe Medias» do të organizon pritjen dhe dërgimin e vullnetarëve dhe të stazhantëve në kuadër të programeve tanimë ekzistuese dhe të financuara. Në këtë mënyrë, këmbimet në pyetje nuk do të jenë në barrë financiare e Rajonit ose Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Gjatë pritjes dhe dërgimit të vullnetarëve dhe stazhantëve, komiteti i pilotimit do të angazhohet për të analizuar kërkesat dhe për të identifikuar vendet e mundshme të pritjes si nga njëra anë ashtu edhe nga tjetra. Nga ana maqedonase, prioritet pritjeje do t ju jepet projekteve të intervenimit direkt në mësimdhënien e frëngjishtes në paralelet dygjuhëshe si mbështetje ekipeve tanimë ekzistuese. Nga ana e Normandisë së Poshtme, përparësi në pritje do t ju jepet projekteve për promovimin e vendit partner në Francë.
Konkretisht, sipas statusit të tyre, nga vullnetarët mund të kërkohet të :

- Organizojnë aksione për mësimdhënie të frëngjishtes
- Organizojnë aktivitete peri-shkollore
- Të rrisin mundësitë e nxënësve dhe studentëve të rinj që të jenë në kontakt me frankofonë

- Të bëjnë shfaqjen e filmave nëpër fshatra.

Aktiviteti 2:

Nevojat për materiale pedagogjike për mësim të frëngjishtes janë të rëndësishme në Maqedoni. Kjo është arsyeja për të cilën ky aktivitet do të koncentrohet në mbledhjen e materialit pedagogjik audiovisual (libra, kaseta, DVD, postera, etj.) i cili do të ishte util në të mësuarit e frëngjishtes. Konkretisht, një mbledhje materialesh do të organizohet në bashkëpunim me një shoqatë të aftë për të bërë përzgjedhjen.

Aktiviteti 3:

Përderisa rajoni i Normandisë së Poshtme ka shprehur fuqimisht dëshirën për të vendosur raporte të qëndrueshme me një ose më tepër shkolla të mesme maqedonase, Ambasada e Francës mund shumë shpejtë të jetë në kërkim të një shkolle të mesme për të realizuar një vëllazërim me një shkollë nga Tetova. Pas takimit shkollor në dhjetor 2007, aksione për sensibilizim të shkollave të mesme në Normandi të Poshtme do të realizohen me drejtorët e tyre me qëllim të realizimit të këtij vëllazërimi në vjeshtë të 2007-ës.

Aksioni 2.4: Bashkëpunimi rreth memories dhe edukimit mbi paqen

Ky aksion do të realizohet pa financim të drejtpërdrejtë nga ky projekt, porse do të kërkohen bashkëpunime për realizim të tij.

Maqedonia ka qenë një prej teatrove kryesorë të frontit të Lindjes i cili nën udhëheqjen e gjeneralit Franchey Esperey, ju lejoi trupave aleate, veçanërisht atyre serbe dhe franceze, të ngjiten triumfalisht nga Selaniku deri në Beograd, në vitet 1917-1918. Bëhet fjalë për një episod të rëndësishëm të Luftës së Parë Botërore, porse të harruar në Evropën perëndimore.

- cf. Fishi ynë «Relacionet franko-maqedonase» [http://crbn-mk.courriers.info/relacionet-franko-maqedonase]

Maqedonia ishte varri i dhjetëra mijë ushtarëve aleatë, serbë, francez ose të dalë nga trupat koloniale. Shumë të rëndësishme janë varrezat ushtarake franceze dhe teatri i komemoracioneve të rregullta në Shkup dhe Manastir. Duke mos u përfunduar kërkimet, shumë ushtarë francez kanë mbetur nëpër malet e Maqedonisë pa u varrosur. Ngandonjëherë vendet ku ata prehen janë të njohura, porse vështirësitë e terrenit e kanë penguar një kërkim më të thelluar.

Duke pasur parasysh se Normandia e Poshtme është një vend i rëndësishëm në kujtim të Luftës së Dytë Botërore, një bashkëpunim në drejtim të këtyre vendeve të kujtimeve, mund lehtë të realizohet dhe kjo veçanërisht në sferën e qasjes në këto vende, të prezantimit të tyre dhe të zhvillimit të një kulture të lirisë. Në këtë drejtim, përvoja e Memorialit të qytetit Caen do të kishte qenë mëse domethënëse.

Impakti i pritur në fund të projektit

- Konsultim dhe implikim i të rinjve në procesin e vendimmarrjes, qoftë vetvetiu, qoftë nga autoritetet lokale
- Zhvillim i marrëdhënieve në mes organizmave pritës dhe dërgues të të rinjve nga të dy territoret dhe këmbim i rregullt i vullnetarëve
-

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

- Kapacitet më i mirë pedagogjik për institucionet maqedonase të mësimdhënies së frëngjishtes
- Zhvillim i këmbimeve në mes institucioneve shkollore nga të dy territoret

Përkthyer nga Afrim Jashari

Copyright © BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE